



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1301/2 Prot.

Tiranë, më 11. 10. 2021

V E N D I M

Nr. 193, Datë 11. 10. 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 166 Regj., datë 16.09.2021, të shtetasit D. D¹, kundër Bashkisë Kurbin, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, në parashtrimet e sjella pranë KMD-së, ndër të tjera citon se: “Në tërmetin e datës 26.11.2019 më është prishur shtëpia ku banoja, në Fushë-Mamurras, Bashkia Kurbin. Shtëpia kishte 3 (tri) dhoma dhe 1 (një) banjo. Pas tërmetit erdhi Komisioni i Vlerësimit, i cili e ka cilësuar shtëpinë si “të pabanueshme” (DS5). Familja ime përbëhet prej 4 anëtarësh. Kam shkuar në Bashkinë Kurbin, por Zyra e Rindërtimit nuk ka pranuar ta regjistrojë edhe pse ajo është cilësuar e pabanueshme. Për këtë arsye jam detyruar të largohem nga Shqipëria familjarisht, ndërsa babai u shpëngul në Kamëz, ku jeton në banesë me qira. Unë nuk kam përfituar as bonus, as ndihmë dhe as regjistrim për shtëpi të re, ndërkohë që shumë persona të tjerë janë regjistruar edhe pse nuk u takonte. Kryetarja e Bashkisë është shprehur se nuk do të më japë shtëpi”.

¹ Përfaqësuar me prokurë të posaçme, nga i ati, H. D.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri: *“Të konstatojë diskriminimin nga ana e Bashkisë Kurbin dhe t’i rekomandojë asaj futjen e emrit tim në sistem, vlerësim të ndërtimit të shtëpisë ose t’me japë bonus sipas ligjit”*.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës nr. 1301/1 prot., datë 28.09.2021, KMD, i ka kërkuar ankuesit³ të saktësojë dhe dokumentojë shkaqet e pretenduara (*“gjendjen ekonomike”* dhe *“çdo shkak tjetër”*) dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm⁴.

Në vijim të sa më sipër, në tejkallim të afatit të caktuar nga Komisioneri, lidhur me plotësimin e elementëve formalë të ankesës së tij, subjekti ankues, nuk ka depozituar parashtrime, fakte apo prova lidhur me sa ka pretenduar pranë KMD-së.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar⁵, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën

³ Referuar kuponit postar me bar –kod: RR 656 761 450 AA, provohet se ankuesi ka marrë dijëni për shkresën.

⁴ Duke kërkuar specifikisht nga ankuesi (përfaqësuesi i tij ligjor):

- Shpjegime, fakte e prova që provojnë *“gjendjen ekonomike”*.
- Shpjegime, fakte dhe prova për të identifikuar *“çdo shkak tjetër”*.
- Shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me personat e tjerë që kanë përfituar nga programi i Rindërtimit të banesave, për secilin nga shkaqet e pretenduara (emrat e personave që janë trajtuar ndryshe nga ju, ndodhur në kushte të njëjta, siç është pretenduar).
- Informacion nëse jeni ankuar për trajtim diskriminues pranë Bashkisë Kurbin. Nëse po, kopje të akteve.
- Kopje të dokumentacionit me anë të të cilit keni aplikuar apo kërkuar të përfshiheni në programin për rindërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, nëse dispononi.
- Çdo informacion tjetër, që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

⁵ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin ankuesi pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshëmritë e pretenduara nga ankuesi lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Sa i takon pretendimit të tij për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvehte.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁶. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁷.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristike personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturë të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me

⁶ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁷ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron si tillë.

Gjendja ekonomike, si shkak i ndaluar diskriminimi është një koncept i gjerë por kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërorë të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës, në pamundësi shoqërore, arsimore, intelektuale, materiale, kulturore deri dhe ekzistenciale⁸.

Në këtë kontekst, ankuesi nuk ka sjellë asnjë indicie, fakt apo provë që të dokumentojë, se ai e mbart këtë shkak dhe se pikërisht bazuar në pamundësinë ekonomike të tij, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga Bashkia, në ndryshim nga individë të tjerë (*sipas pretendimit të ankuesit*) të cilët financiarisht, gëzojnë një “gjendje ekonomike” më të mirë se ai.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

- Referuar citimit sa më lart, ankuesi nuk solli asnjë provë që të dokumentonte “shkaqet” e pretenduar prej tij: *“gjendjen ekonomike”* apo *“çdo shkak tjetër”*.
- Komisioneri nuk ka evidentuar një karakteristikë personale ose të identifikueshme të ankuesit, e cila, në përputhje me rrethanat e çështjes të kishte shërbyer si shkak për trajtimin e tij të padrejtë apo të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Kurbin.
- Referuar deklarimeve të ankuesit, ai ka pohuar se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me persona të tjerë, por nuk ka identifikuar asnjë person konkretisht, dhe as ka dhënë asnjë indicie mbi bazën e të cilës të prezumohej ky trajtim i pabarabartë e i pafavorshëm.

Diskriminimi⁹ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

⁸ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

⁹ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkaqeve të pretenduara nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, që për problematikën e tij, t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike¹⁰, ose Shërbimit Ligjor Falas¹¹.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, D. D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe Shërbime

Shkaku: “Gjendja ekonomike” dhe “çdo shkak tjetër”

Lloji i vendimit: Mospranim

¹⁰ Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

¹¹ Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.